



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1659 prot

Roskovec, më 26.02.2026

VENDIM

NR 12. DATË 26.02.2026

“PËR MIRATIMIN E BASHKËFINANCIMIT PËR PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL, FOND I MIRATUAR ME VKB NR. 71 DATË 24.12.2025 “PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT PËRFUNDIMTAR TË PBA 2026-2028 DHE BUXHETIT TË VITIT 2026”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, të shkresës Nr.628/2 prot. datë 23.01.2026 "Mbi Fondet për programet e strehimit për vitin 2026" të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit; Udhëzimit Nr.31, datë 18.11.2019, "Për Procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit" referuar Ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", të ndryshuar, të VKB Nr. 71 datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1- Miratimin e bashkëfinancimit prej 50% për programin:

1. Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara për vitin 2026-2027,

2. Subvencion qiraje për vitin 2026;

Fond i miratuar me VKB Nr.71 datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026”; me emërtim “Bashkëfinancime për projekte me qeverinë” me vlerë **3,000,000 lekë** me kod projekti **1130463, TIT. 4520**

NR	GR	TIT	KA P	ART	EMERTIM I PROGRAM IT BUXHETO R	EMERTIM I OBJEKTIT/SH PENZIMIT	NJESI SHPE NZUE SE	VLERA E PLOTE E PROJEKTI T	VLERA E BASHKEF INANCIMI T
1.	00	4520	5	231	<i>Strehimi social</i>	<i>Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara për vitin 2026- 2027</i>	Bashkia Roskov ec	4,294,850	2,147,425

2.	00	4520	5	602	<i>Strehimi social</i>	<i>Subvencion qiraje për vitin 2026</i>	B.Roskovec	480,000	240,000
						SHUMA		4,774,850	2,387,425

2- Ngarkohet Komisioni i Strehimit për kryerjen e procedurave përkatëse dhe zbatimin e këtij vendimi.

3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Afrim Plaka

